

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË**  
**“KIKO 1 ” sh.p.k**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 12.09.2023, ortakët e shoqërise:

**z. Beka Kolila** i datëlindjes 14/12/1970 shtetas Shqiptar, lindur në Vlore, mbajtës i dokumentit karte Identiteti me Nr. H01214050f.

me vullnetin e tyre të lire dhe të plote, të shprehur nepermjet këtij akti themelimi, vendosi për krijimin e shoqërise tregtare “**KIKO 1**” Shpk me kushtet e mëposhteme:

**Neni 1**  
**EMERTIMI**

Shoqëria Tregtare do të ketë Emërtimin “ **KIKO 1** “ Shpk.

**Neni 2**  
**FORMA JURIDIKE**

Shoqëria Tregtare “ **KIKO 1**” Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku në nenin 3 përcaktohet se:

*” 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*

*2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe nënëve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.*

*3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”*

**Neni 3**  
**KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë “ **KIKO 1**” Sh.p.k do të vazhdojë veprimtarinë e saj me një afat kohor të pakufizuar.

*Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të behet në cdo kohë :*

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të ortakëve të shoqërise;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqërise marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërisë.

Nëse Ortaket e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 4**

#### **SELIA**

Shoqëria Tregtare **“KIKO I”** Sh.p.k e ka selinë ne qytetin e Vlores, : Lagjja 24 Maji, Rruga Zahir Pajaziti, Nr 51, Vlorë.

Emali [kiko1@gmail.com](mailto:kiko1@gmail.com)

Tel : 0692505588.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqërisë.

#### **Neni 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

**-Tregti me pakice dhe shumice te cigare dhe artikujve te ndryshem.**

#### **Neni 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren **100,000 lekë** dhe perbehet nga nje kuote:

- **Beka Kolila** është zoterues e 1 kuote me vlere 100,000 qe perben 100 % te kapitalit themeltar

#### **Neni 7**

#### **TRANSFERIMI I KUOTEVE**

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon te shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqërisë blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit ai deshiron t'ia shese. Kur disa ortake ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigjen brenda 30 diteve nese deshirojne te blejne kuotat e ofruara apo jo.

#### **Neni 8**

#### **SHPERNDARJA E FITIMIT**

Ortaket financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.

#### **Neni 9**

#### **ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

Organet Drejtuese te Shoqërisë janë:

1.Administratori,

2.Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.

**Aministrator i Shoqërisë është Z. Beka Kolia e datëlindjes 14/12/1970 shtetas Shqipetar mbajtës i dokumentit karte Identiteti me Nr. H01214050F, me nje mandate 5 vjecar me të drejtë ripërtëritjeje.**

#### **Neni 10**

#### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administrator ushtron kompetenca ne emer te Shoqërisë:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;  
Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
  - b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
  - c) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
  - d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

### **Neni 11**

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë ndahet në periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 12**

Shoqëria mban dokumentacionin e nevojshëm financiar për administrimin e pasurisë dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e të gjithë legjislacionit përkatës në fuqi.

Bilanci financiar i shoqërisë përpilohet në bazë të raportit me shkrim të eksperteve kontabël të autorizuar dhe të raportit të paraqitur nga administratorët brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Të dy raportet paraqiten me miratohen në asamble e ortakëve brenda datës 30 qershor.

Fitimi neto i shoqërisë llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme të vitit të mëparshëm, shlyerja e të gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj çdo personi të tretë, si dhe fondet financiare që përbejnë rezervën e detyrueshme.

### **Neni 13**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE**

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë zgjidhen nga vete ortakët e shoqërisë me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata në territorin e se ciles ndodhet selia e shoqërisë.

### **Neni 14**

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

**ORTAKET E SHOQËRISË “KIKO 1” Sh.P.K**

**BEKA KOLILA**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right.